

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar, mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutin Shoqërisë me nr.1861 Prot. datë 01.09.2022, Rregullorës së brendëshme të Shoqërisë, Marrveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizime Dibër sha, datë 22.07.2022, shpallen procedurat e konkurimit për vend të lirë pune:

1(një) Grup Operimi - Usta Ndërtimi, Njësia Peshkopi

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Grup Operimi - Usta Ndërtimi i Njesisë varen nga ana administrative nga Përgjegjësi i Administratës së Njesisë përkatëse dhe nga ana funksionale nga Drejtori i Drejtorisë Teknike.

Grup Operimit - Usta Ndërtimi ka këto detyra:

1. Kryen punime dhe bën ripaarimet e nevojshme në systemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime.
2. Mirëmban, rrjetin dhe strukturat ekzistuese të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe ujërave të ndotura, në zonës e shërbimit.
3. Zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe përdor me përgjegjësi mjetet e punës.
4. Kryen detyra të tjera të ngjashme të ngarkuara nga eprorët.
5. Është në gatishmëri edhe jashtë orarit të punës dhe në raste emergjencash, kur kërkohet nga eprorët.
6. Raporton për çdo problem, dëmtim apo mosfunksionim në rrjetin e shërbimit.
7. Zbaton disiplinën në punë dhe rregullat e brendshme të institucionit.
8. Përmbush çdo urdhër tjetër të eprorëve (me shkrim ose me gojë), që nuk nie ndesh me ligjin dhe nuk cenon dinjitetin e punonjësit.

Kandidatet duhet të plotesojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Të jenë shtetas shqiptarë;
- ✓ Të kenë përfunduar arsimin e detyrueshëm (9-vjeçar) ose arsimin e mesëm;
- ✓ Të kenë eksperiencë pune në profesion, e preferueshme;
- ✓ Të jenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe të aftë fizikisht për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit përkatës.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

1. Curriculum Vitae (CV);
2. Fotokopje të kartës së identitetit;
3. Fotokopje të librezës së Punës (nëse disponon);
4. Çertifikatë personale;
5. Çertifikatë e gjendjes familjare;
6. Diplome shkolle (e noterizuar);
7. Listë notash (e noterizuar);
8. Dokumente që vërtetojnë kualifikime ose eksperiencë pune (nëse ka);
9. Dëshmi Penaliteti;
10. Vërtetim i Gjendjes Gjqësore;
11. Vërtetim prokurorie;
12. Saktësim adrese nga Bashkia;
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë);
14. Foto të vogla dy (2 copë), foto e madhe një (1 copë).

Kandidatet do të vleresohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe nevojave të institucionit.

Në përfundim të procesit të vlerësimit , Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a, përmes Drejtorisë së Shërbimeve dhe Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore, do të shpallë fituesin në portalin e “ Shërbimit Kombëtar të Punësimit”.

Kandidatet jo fitues kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a., brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së fituesit. Ankesa protokollohet dhe shqyrtohet nga Sektori Juridik, në përputhje me aktet e brendshme dhe legjislacionin në fuqi.